

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetar i trupit gjykues Afrim Shala, me sekretaren juridike Vahide Dërmaku, në çështjen penale ndaj të pandehurit R. D., nga ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati M. M., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose i autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.303/2013, e datës 26.12.2013, të cilën e përfaqësonte prokurori Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 07.05.2014, mori dhe publikisht shpalli këtë :

## AKTGJYKIM

I pandehuri R. D., nga babai I. dhe nëna Xh., e lindur L., i lindur më ..., në fshatin Sh., Komuna e K., tani me vendbanim në Gj., lagjja "...", rr..., nr..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i ... fëmijëve, punon si ... në ... në Gj., i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën e ...,

## ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën ...2013, ka shpërdorë pozitën zyrtare dhe autoritetin në atë mënyrë që duke qenë në pozitën e zyrtarit përkatësisht punëtorit ... në ..., ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror në atë mënyrë që për automjetin zyrtar të ... të tipit "...", me tabela të regjistrimit ..., ka sjellë faturën me nr. ... të datës ... .2013, me arsyetim se ka mbushur me derivate të naftës prej ... litra këtë veturë, ndërkaq një ditë para datës kritike e njëjta veturë është mbushur nga një zyrtar i ... me naftë prej ... litrash dhe është shfrytëzuar e njëjta veturë vetëm prej ... kilometra rrugë dhe me të njëjtën gjendje të kilometrazhesh së fundit është gjetur pas dorëzimit të faturës prej ... litra për mbushjen e së njëjtës nga i pandehuri dhe me këtë i pandehuri ka shpërdorë pozitën zyrtare duke e dëmtuar ATK për sasinë e naftës së faturuar prej ... litra,

- me këtë ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare ose i autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK.

Andaj, kryetari i trupit gjykues, në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK, si dhe nenit 233 paragrafi 21, nenit 247 dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP),<sup>2</sup> të pandehurit i shqipton :

**DËNIM ME BURGIM I CILI ME PËLQIMIN E TË PANDEHURIT ËSHTË ZËVENDËSUAR NË DËNIM ME GJOBË**

<sup>1</sup> Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Në tekstin e mëtejme KPRK), nr.04/L-082, i datës 20.04.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

<sup>2</sup> Kodi i Procedurës Penale (Në tekstin e mëtejme KPP), nr.04/L-123, i datës 13.12.2012, i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2013.

Ashtu që të pandehurit R. D., i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej 1,800.00 € (njëmijetëqind Euro), të cilin dënim i pandehuri do ta paguajë në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) muajve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të pandehurit, në vend të shqiptimit të dënimit me burgim, ta zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme do të llogariten me 20 (njëzet) Euro të dënimit me gjobë.

Detyrohet i pandehuri R. D., që të dëmtuares ... në Gj., t'ia kompenzojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 78 € (shtatëdhjetëtetë Euro), në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Detyrohet i pandehuri që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## ARSYETIMI

### 1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 26.12.2013 ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit R. D., nga ..., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose i autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK. Po ashtu, më datën ....2014, në këtë Gjykatë është dorëzuar edhe një marrëveshje për pranimin e fajësisë e lidhur në mes të Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda, në njërën anë dhe të pandehurit R. D. dhe mbrojtësit të tij, avokatit M. M., nga ..., në anën tjetër. Sipas kësaj marrëveshje, kësaj Gjykate, i është rekomanduar që ndaj të pandehurit R. D., për shkak të kryerjes së veprës penale të lartcekur t'i shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, me mundësi të zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë.

### 2. Vlerësimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën ....2014, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit e ka pranuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme, me mbrojtësin e tij, avokatin M. M.; se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanta e parapara në nenin 253 paragrafi 1 të KPP.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, kryetari i trupit gjykues e ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

-se i pandehuri R. D., me dashje dhe me qëllim përvetësimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore e ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Kryetari i trupit gjykues, pas dëgjimit deklarave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të pandehurin R. D., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njejtë, siç e ka pranuar edhe vetë, më datën ... .2013, ka shpërdorë pozitën zyrtare dhe autoritetin në atë mënyrë që duke qenë në pozitën e zyrtarit përkatësisht punëtorit ... në ..., ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm pasuror në atë mënyrë që për automjetin zyrtar të ... të tipit "...", me tabela të regjistrimit ..., ka sjellë faturën me nr. ... të datës ... .2013, me arsyetim se ka mbushur me derivate të naftës prej ... litra këtë veturë, ndërkaq një ditë para datës kritike e njëjta veturë është mbushur nga një zyrtar i ... me naftë prej ... litrash dhe është shfrytëzuar e njëjta veturë vetëm prej ... kilometra rrugë dhe me të njëjtën gjendje të kilometrazhesh së fundit është gjetur pas dorëzimit të faturës prej ... litra për mbushjen e së njëjtës nga i pandehuri dhe me këtë i pandehuri ka shpërdorë pozitën zyrtare duke e dëmtuar ... për sasinë e naftës së faturuar prej ... litra.

#### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Kryetari i trupit gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se duhet të aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrëveshjen për pranimin e fajësisë që ndaj të pandehurit R. D., të shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve dhe me pëlqimin e të pandehurit, këtë dënim e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 1,800.00 € (njëmijetëqind Euro), ngase ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.<sup>3</sup> Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit dhe zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë, kryetari i trupit gjykues i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenet 73 deri 76 të KPRK. Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës kryetari i trupit gjykues e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se i pandehuri ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjilan, Departamenti i Krimeve të Rënda.<sup>4</sup> Gjithashtu, si rrethana posaçërisht lehtësuese, kryetari i trupit gjykues e ka marrë për bazë edhe faktin se i pandehuri ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit; se pranimin e fajësisë e ka bërë gjatë të gjitha fazave të procedurës penale; se i pandehuri është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale; se i njejtë ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra tjera penale; sjelljen korrekte gjatë shqyrtimeve fillestare; se ka shprehur gatishmëri që të palës së dëmtuar ... në Gj., t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar; se është i martuar dhe baba i ... fëmijëve; si dhe fakti se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe i pandehuri me të drejtë mund të pritë që në të ardhmen nuk do të kryejë ndonjë vepër tjetër penale. Ndërsa, kryetari i trupit gjykues nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese në këtë çështje penale.

<sup>3</sup> Në nenin 47 të KPRK, është parashikuar se “kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në gjashtë (6) muaj, gjykata njëkohësisht mund të vendosë që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënim me gjobë, me pëlqimin e personit të dënuar”.

<sup>4</sup> Në nenin 75 paragrafi 1 nënparagrafi 3 të KPRK, është parashikuar se “gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rastet kur është arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë. Në raste të tilla, gjykata merr parasysh mendimin e prokurorit dhe mbrojtësit sa i përket zbutjes së dënimit dhe udhëzohet por nuk detyrohet nga kufizimet e parapara në nenin 76 të KPRK”. Ndërsa, në nenin 76 paragrafi 1 nënparagrafi 6 të KPRK, është parashikuar se “kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 75 i KPRK, gjykata mund ta zbusë dënimin dhe të shqiptojë dënimin me burgim deri në 30 (tridhjetë) ditë, nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim më pak se 1 (një) vjet”. Për veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose i autoritetit zyrtar, nga neni 422 paragrafi 1 të KPRK, si masë më e ulët e dënimit është dënimi me burgim prej së paku 6 (gjashtë) muaj.

## 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së kryetarit të trupit gjykues, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili me pëlqimin e të pandehurit R. D., është zëvendësuar në dënim me gjobë në shumë prej 1,800.00 € (njëmijetëqind Euro), duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Kryetari i trupit gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

## 7. Zëvendësimi i dënimit me gjobë

Kryetari i trupit gjykues duke u bazuar në nenin 46 të KPRK, ka vendosur që nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzetë Euro) të dënimit me gjobë do të caktohet nga 1 (një) ditë burgim.

## 8. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Duke bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, është detyruar i pandehuri R. D., që të dëmtuares ... në Gj., t'ia kompenzojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 78 € (shtatëdhjetë Euro), në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, kryetari i trupit gjykues, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për ta paguar vetëm paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë Euro) në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 08.05.2014

Sekretarja juridike,  
Vahide Dërmaku

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.